



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 658/2015

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Gentian Këri	Kryetar
Spiro Kuro	Zv/Kryetar
Juliana Hoxha	Anëtar
Leonard Gremshi	Anëtar
Hektor Balluku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 20.10.2015 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Shfuqizim i vendimit të komisionit të vlerësimit të ofertave në lidhje me skualifikimin e operatorit ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. nga procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat, me fond limit 727.962 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit”.

Ankimues:

“Zenit - 06” sh.p.k.
Rr. “Myrteza Topi”, Ndërtesa 18, Hyrja 7, Ap. 38, Kodi Postar 1017, Nj.Bash. 9, Tiranë

Autoriteti Kontraktor:

Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tiranë

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.08.2015, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat, me fond limit 727.962 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 04.09.2015, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

- | | |
|--|----------------------------|
| 1. “Zenit - 06” sh.p.k. | 475.500 lekë, skualifikuar |
| 2. “Alb Supervizion – D.S.” sh.p.k. | 500.000 lekë, skualifikuar |
| 3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Infratech” sh.p.k.
& “Vler Invest” sh.p.k. | 567.900 lekë, kualifikuar |
| 4. “Novatech Studio” sh.p.k. | 662.445 lekë, kualifikuar |

II.3. Në datën 10.09.2015 operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Formulari i ofertës nuk është sipas formularit të dhënë në Dokumentat Standarte të Tenderit dhe në të nuk është shënuar vlera pa TVSH dhe me TVSH.*
- *Oferta e paraqitur është më e ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territory, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.*

II.4. Në datën 15.09.2015, operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë pretendohet si më poshtë:

[...] Kundërshtojmë vendimin e KVO për skualifikimin e ofertës sonë me arsyet se sipërpërmendura sepse ato janë të pambështetura në ligj dhe dokumentat që kemi paraqitur.

Konkretisht:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit – kemi paraqitur formularin e ofertës sipas formularit të dhënë në DST sepse pikërisht e kemi shkarkuar nga DST që ju keni ngarkuar në sistem.*

Në atë formular është shkruar:

Për lotin I: “Loti 1: “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat, Loti 1”

Vlera pa TVSH 475.500 Lekë pa TVSH

Vlera me TVSH 570.600 Lekë me TVSH

Për sa më sipër kjo arsye e skualifikimit nuk qëndron dhe shpresojmë që është një lapsus i juaji i marrë copy – paste nga skualifikimi i ndonjë operatori tjetër.

- *Lidhur me arsyen e dytë të skualifikimit duke pretenduar se oferta jonë është më e ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”.*

Kjo arsye skualifikimi është haptazi e kundraligjshme dhe bërë me qëllim të përcaktuar për të shpallur fituese ofertën e klasifikuar në vend të parë. si mundësi e vetëm për ta shpallur atë fituese ishte përdorimi i kësaj arsye absurde çka diskretiton KVO për paravendosje të fituesit.

Konkretisht:

Kjo është një arsye jashtë kriterëve të përcaktuara në DST dhe parimeve të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik. Si kriter vlerësimi për këtë procedurë ka qenë çmimi më i ulët i ofertës së paraqitur.

KVO pranon se çmimi më i ulët është i Zenit 06 sh.p.k. por pretendon se ky çmim është më i ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 29.10.2014.

Praktikisht kjo vjen në kundërshtim të hapur me përcaktimet e nenit 55 të ligjit të prokurimeve ku shprehimisht thuhet:

“Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter që nuk është i përfshirë në dokumentat e tenderit”.

Edhe në rastin e supozuar se çmimi ynë është më i ulët se vlera minimale e lejuar KVO ka detyrimin ligjor të argumentojë dhe të arsyetojë këtë vendim skualifikimi.

Cili është çmimi minimal i lejuar, si përllogaritet ai dhe sa është kjo ulje në rastin e ofertës së Zenit 06 nga çmimi i lejuar ?????

Por KVO nuk e ka bërë këtë gjë por thjesht bën një formulim të përgjithshëm duke pretenduar për çmim më të ulët se ai minimal i lejuar, pikërisht sepse nuk ka ku ta mbështesë këtë pretendim.

Kjo vjen në kundërshtim të hapur me përcaktimet e neneve 108 dhe 109 në Kodin e Procedurave Administrative ku theksohet se mungesa e arsytimit sjell pavlefshmërinë e aktit. [...]

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe rregullat e prokurimit publik përcaktojnë se për të mbrojtur në rastin e ofertave të vlerave të ulëta, AK mund të përdorë formulën e ofertës anomalisht të ulët.

Pra nqs oferta jonë do të konsiderohej anomalisht e ulët (formulimin nën çmimin e lejuar nuk e njeh ligji i prokurimit [...]), atëherë duhej të zbatonte përcaktimet e nenit 56 të LPP duke kërkuar shpjegime me shkrim për çmimin e ofruar.

[...]

Nqs KVO nëpërmjet aplikimit të kriterit të çmimit më të ulët të lejuar, ka dashur të mbrojë AK nga ofertat e papërgjegjshme këtë nuk ka tagër ta bëjë duke shpikur kritere jo ligjore por ligji ka mirëpërcaktuar instrumenta dhe mekanizma që ia mundësojnë këtë edhe gjatë fazës së zbatimit të kontratës pa qenë nevoja për shpikje të tilla. Por KVO e ka bërë këtë gjë vetëm sepse kështu mund të shpallë fitues operatorin e paracaktuar.

Aplikimi nga KVO i një kriteri të tillë të pambështetur në ligj vjen në kundërshtim të hapur me praktikën më të mirë të vendimmarrjeve për skualifikim por edhe parimeve bazë të ligjit për prokurimin publik ku përcaktohet se qëllimi i ligjit është mirëadministrimi i fondeve dhe nxitja e konkurrencës.

[...]

Vendimi i KVO për skualifikim të ofertës sonë për arsye të pambështetura ligjrisht bie ndesh edhe me parimet e sipërcituara sepse diferenca e ofertës sonë me ofertën e kualifikuar si fitues është 92.400 lekë pa tvsh.

Oferta jonë plotëson kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit duke garantuar zbatimin me sukses të kontratës ndërkohë që ofron edhe velrën më të ulët – që janë e duhet të jenë edhe qëllimet kryesore në një procedurë.

Për sa më sipër kërkojmë anulimin e vendimit të KVO të datës 10 Shtator 2015, ora 09:16 për skualifikimin e ofertës të Zenit 06 sh.p.k. si të pambështetur në ligj dhe kualifikimin e ofertës sonë sepse kemi paraqitur të plotë të gjithë dokumentacionin administrativ dhe kualifikues të kërkuar në DT.

II.5. Në datën 17.09.2015 me shkresën nr. 1738/2 prot., autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke e pranuar pjesërisht ankesën. Konkretisht autoriteti kontraktor ka pranuar ankesën në lidhje me arsyen e skualifikimit përsa i përket formularit të ofertës dhe nuk e ka pranuar atë në lidhje me shkakun e skualifikimit se *oferta e paraqitur është më e ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territory, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”*.

II.6. Në datën 25.09.2015 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, nëpërmjet të cilës kundërshton skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit.

II.7. Në datën 29.09.2015, nëpërmjet shkresës me nr.1812/2 prot., datë 28.09.2015, me objekt: *“Dërgim dokumentacioni”*, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. se arsyeja e skualifikimit *“Oferta e paraqitur është më e ulët se vlera minimale e lejuar e përcaktuar në nenin 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 704, datë 29.10.2014 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”*, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.1.1. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”*.

III.1.2. Në nenin 53, pika 3 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... .”*

III.1.3. Në nenin 53, pika 1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Autoriteti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave [...]”.

III.1.4. Në nenin 56 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, përcaktohet se: “1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për:

a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj”.

III.1.5. Konstatohet se autoriteti kontraktor nuk i është referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik në lidhje me zbatimin e formulës për ofertën anomalisht të ulët, por ka bërë vlerësimin referuar vlerës minimale të fondit limit, duke përcaktuar një diapazon të këtij të fundit për të kualifikuar/skualifikuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se nuk është e pranueshme që autoriteti kontraktor të kryejë apo të pretendojë të kryejë vlerësimin e ofertave ekonomike duke vendosur kufij minimalë, nën të cilin do të skualifikohen automatikisht ofertat ekonomike të operatorëve pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, pasi kjo vjen në kundërshtim me legjislacionin për prokurimin publik, sipas të cilit fillimisht zbatohet formula për të vlerësuar nëse një ofertë është anomalisht e ulët ose jo dhe më pas, në varësi të rezultatit, autoriteti kontraktor i kërkon operatorit ekonomik të paraqesë sqarimet dhe dokumentacionin me të cilin ky i fundit argumenton elementët e veçantë të ofertës së tij ekonomike, duke mbajtur në konsideratë edhe legjislacionin e posaçëm që rregullon tarifat për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim.

Përcaktimi i kufijve të tillë, bie në kundërshtim edhe me vetë frymën dhe qëllimin e ligjit të përcaktuar në nenin 1 të tij, duke frenuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë dhe duke bërë një trajtim jo të barabartë dhe diskriminues të këtyre operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik.

Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, pretendimi i operatorit ekonomik “Zenit – 06” qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim”, Loti I “Mbikqyrja e punimeve për objektin: “Rehabilitimi i gjelbërimit anësor dhe rrethrotullimeve në segmentin Lushnje-Berat, me fond limit 727.962 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 04.09.2015, nga autoriteti kontraktor, Fondi Shqiptar i Zhvillimit.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e operatorit ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Zenit - 06” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1551 Protokoli,
Datë 25.09.2015



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Spiro Kuro

Anëtar
Juliana Hoxha

Anëtar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Kryetar
Gentian Këri